

Avantazhet tuaja, kur hapni DEP-në tuaj personale:



Në një emergjencë

Me EPD-në profesionistëve shëndetësorë u jepet shpejt mundësia për qasje në informacione të rëndësishme.



Disa mjekë trajtues

Edhe në sëmundje të disafishta të gjithë profesionistët shëndetësorë janë në të njëjtën shkallë dijenie.



Për gjithë familjen

Prindërit mund të administrojnë p.sh. EPD-në e fëmijëve të tyre. Kështu nuk harrohet më asnjë vaksinim.



Lista e medikamenteve

Falë EPD-së të gjithë personat me leje qasjeje kanë njohuri të përgjithshme për mjekimin aktual.

**Zbuloni avantazhet
e dosjes elektronike
të pacientit.
DEP-ja ka efekt.**



DEP

Dosja elektronike
e pacientit

Zgjidhni tani ofruesin tuaj të EPD-së:
dosijepacientja.ch

Art.311.222.sq



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra


Swiss Confederation

Një fushatë partnere
e Zyrës Federale të Shëndetit
Publik BAG dhe kantoneve.

Për të gjithë, që duan t'i marrin informacionet e tyre të shëndetit vetë në dorë.

Dosja elektronike e pacientit (EPD) është një koleksion digjital i informacioneve të rëndësishme në lidhje me shëndetin tuaj, që është i njësisshëm në gjithë Zvicrën. Me anë të një lidhjeje të sigurt interneti, në çdo kohë mund të arrini tek informacionet tuaja. Profesionistëve shëndetësorë u mundësohet qasja, nëse ju e lejon.

Dosja elektronike e pacientit e lehtëson bashkëpunimin e të gjithë profesionistëve shëndetësorë të përfshirë, gjë që sjell përfitime të drejtpërdrejta për ju si paciente ose pacient.



Informohuni tani:
dosijepacijenta.ch

Shpjegim i shkurtër për EPD-në:

- EPD-ja është një koleksion digjital për informacionet tuaja shëndetësore në lidhje me trajtimin mjekësor
- EPD-ja kursen kohë dhe rrit sigurinë e trajtimit.
- Me EPD-në informacione të rëndësishme janë shpejt në dispozicion, edhe në një emergjencë.
- Ligji për mbrojtjen e të dhënave dhe Ligji konfederal mbi dosjen elektronike të pacientit garantojnë siguri maksimale dhe mbrojtjen e të dhënave tuaja në EPD.
- Për njerëzit në Zvicër EPD-ja është vullnetare dhe pa pagesë.
- Për institucione shëndetësore me hospitalizim (p.sh. spitale dhe strehimore përkujdesjeje) si dhe për ordianca mjekësore me licencim të ri pjesëmarrja është e obliguar.